



Raport Përmbyllës i Zgjidhjes së Problemit

Hekurudha Shqiptare
BERZH Numër Projekti 48466
Çështja 2023/02

Qershor 2026

PUBILKE

Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit (IPAM) është mekanizmi i Llogaridhënies së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). IPAM-i shqyrton në mënyrë të pavarur çështjet e ngritura nga individë ose organizata në lidhje me projektet e financuara nga Banka, të cilat besohen se kanë shkaktuar dëm ose kanë gjasa të shkaktojnë dëm. Qëllimi i mekanizmit është të lehtësojë zgjidhjen e çështjeve sociale, mjedisore dhe publike të bërjes publike të informacionit ndërmjet palëve të interesit të projektit; të përcaktojë nëse Banka ka vepruar në përputhje me Politikën e saj Mjedisore dhe Sociale dhe dispozitat specifike të projektit të Politikës së Aksesit në Informacion; dhe, aty ku është e zbatueshme, të adresojë mospërputhjet e mundshme me këto politika, duke shmangur mospërputhjet e ardhshme nga ana e Bankës. Për më shumë informacion lidhur me IPAM-in, kontaktoni ose vizitoni www.ebrd.com/project-finance/ipam.html.

Informacion Kontakti

Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Rruga Five Bank
Londër E14 4BG

Telefon: +44 (0)20 7338 6000
Email: ipam@ebrd.com

Si të depozitoni një ankesë IPAM-it


Shqetësimet lidhur me performancën mjedisore dhe sociale të një Projekti të BERZH- së mund të dorëzohen nëpërmjet Email-it ose nëpërmjet formularit online në: 
<https://www.ebrd.com/project-finance/ipam.html>

TABELA E PËRMBAJTJES

MIRËNJOHJE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
LISTË SHKURTIMESH	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
1. SFODNI.....	8
1.1. Kërkesa.....	8
1.2. Projekti.....	8
1.3. Trajtimi deri më tani.....	8
2. VEPRIMTARITË E MONITORIMIT TË MARRËVESHJES	9
3. REZULTATET E ZGJIDHJES SË PROBLEMIT	11
4. MËSIMET E NXJERRA.....	12
5. PËRFUNDIMI DHE HAPAT E ARDHSHËM	12

Nëse nuk tregohet ndryshe, termat e shkruar me shkronjë të madhe në këtë raport janë ata të përcaktuar në Politikën e Llogaridhënies së Projektit të vitit 2019.

MIRËNJOHJE

IPAM-i dëshiron të falënderojë Kërkuesit, Përfaqësuesin e tyre, Hekurudhën Shqiptare, Bashkinë e Vorës, Njësinë Administrative të Bërxullës, Menaxhimin e BERZH-it dhe aktorët e tjerë të përfshirë në Inicativën e Zgjidhjes së Problemit për bashkëpunimin e tyre, sqarimet dhe përfshirjen konstruktive përgjatë procesit.

Gatishmëria e Palëve për të vijuar dialogun, për të shkëmbyer informacione dhe për të punuar drejt një zgjidhjeje praktike për aksesin ishte thelbësore për të përfunduar me sukses veprimet e dakordësuara dhe për të mbyllur Çështjen.

LIST SHKURTIMESH

Shkurtime	Forma e Plotë
Bank	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Bord	Bordi i Drejtorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Çështja	shqyrtimi i një Kërkesë sipas Politikës së Llogaridhënies së Projektit pas regjistrimit të saj.
Regjistri Çështjeve	i regjistri i çështjes së krijuar në përputhje me Politikën e Llogaridhënies së Projektit
Klient	Hekurudha Shqiptare, Subjekti Zbatues i Projektit
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
ESP	Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it në fuqi gjatë kohës së miratimit të Projektit
IPAM	Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
PAP	Politika e Llogaridhënies së Projektit 2019
Palët	Kërkuesit, Përfaqësuesi i tyre, Klienti, Menaxhimi i BERZH-it dhe aktorë të tjerë të përfshirë drejtpërsëdrejti në procesi e Zgjidhjes së Problemit
Zgjidhja Problemit	e funksioni i IPAM-it i cili ndihmon në mënyrë vullnetare zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Kërkueseve dhe Klientëve për të zgjidhur çështjet mjedisore, sociale dhe publike të ngritura në Kërkesë, pa ngarkuar palët me faj apo përgjegjësi
President	Presidenti Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Projekt	Projekti i Hekurudhës Shqiptare, Numri i Projektit të BERZH-it 48466
PSD	Dokumenti i Përmbledhjes së Projektit
Kërkesa	Komunikimi i paraqitur i IPAM-it nga Kërkuesit ose Përfaqësuesi i tyre sipas Politikës së Llogaridhënies së Projektit
Kërkuesit	individët që paraqitën, ose në emër të të cilëve një Përfaqësues paraqiti, Kërkesën pranë IPAM-it

Përmbledhja Ekzekutive

Ky Raport Përmbyllës i ofron Bordit të Drejtorëve dhe Presidentit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim një përmbledhje të procesit të Zgjidhjes së Problemit të IPAM-it dhe aktiviteteve të monitorimit për **Çështjen 2023/02** në lidhje me **Projektin e Hekurudhës Shqiptare (Numri i Projektit të BERZH-it 48466)**. Çështja kishte të bënte me një problem praktik që cenonte aksesin e komunitetit të Bërxullës në Bashkinë Vorë, Shqipëri, dhe ilustron se si angazhimi i hershëm, mandati i përqendruar dhe dialogu i drejtpërdrejtë ndërmjet Palëve mundësojnë një zgjidhje të zbatueshme dhe në kohë.

Kërkesa u paraqit pranë IPAM-it më 15 dhjetor 2022 nga z. Ditmir Zeqa, duke vepruar si përfaqësues i 60 individëve që banojnë në Bërxull. Kërkuesit ishin të shqetësuar se mbyllja e kalimit në nivel që përdorej nga komuniteti do të kufizonte aksesin e tyre në shtëpi, biznese dhe në xhaminë lokale pasi korridori hekurudhor të rrethohej me gardh. Kalimin alternativ për automjete, të propozuar në kuadër të Projektit, e konsideronin si shumë të largët për këmbësorët ndërsa rrugët lidhëse që ofronin akses nuk i shikonin si të përshtatshme për mjete të rënda. Për rrjedhojë, Kërkuesit parashtruan kërkesën e tyre për mbështetje nga IPAM-i përmes Zgjidhjes së Problemit për të përcaktuar një mënyrë që do të rregullonte aksesin dhe do të përmbushte si nevojat e komunitetit, ashtu edhe kushtet e Projektit.

Çështja kaloi shpejt nga regjistrimi në zgjidhje. **IPAM-i e regjistroi Kërkesën më 6 shkurt 2023**, zhvilloi konsultime vlerësuese dhe një mision në terren, dhe konfirmoi se Palët ishin të gatshme të angazhoheshin në një Iniciativë për Zgjidhjen e Problemit. Brenda më pak se gjashtë muajve nga regjistrimi, **IPAM-i lehtësoi zhvillimin e një takimi të përbashkët në Bërxull më 26 korrik 2023, në të cilin Palët ranë dakord për një zgjidhje teknike për aksesin dhe nënshkruan një Marrëveshje konfidenciale për Zgjidhjen e Problemit**. Marrëveshja trajtoi shqetësimin kryesor të ngritur në Kërkesë duke i siguruar akses të përkohshëm të vazhdueshëm përmes kalimit ekzistues në nivel deri në momentin kur zgjidhja përfundimtare e aksesit të bëhej funksionale.

Çështja u zgjidh përmes një pakete angazhimesh të mirëpërcaktuara dhe të realizueshme. Hekurudha Shqiptare ra dakord të ruante aksesin e përkohshëm gjatë kryerjes së punimeve dhe të realizonte një zgjidhje të përhershme që përbëhej nga një nënkalim pranë xhamisë për këmbësorët dhe mjete të vogla dhe një rrugë shërbimi e përshtatshme për mjete të rënda. Zgjidhja teknike iu prezantua drejtpërsëdrejti Kërkuesve dhe u përshtat pas komenteve të tyre, duke u siguruar se punimet e dakordësuara do t'u përgjigjeshin nevojave praktike të komunitetit për akses.

Gjatë monitorimit, **IPAM-i verifikoi procesin e zbatimit përmes angazhimit të rregullt me Palët, takimeve virtuale dhe në terren, shqyrtimit të dokumenteve, përditësimeve nga palët e interesuara dhe vizitave në terren**. IPAM-i përgatiti tre raporte monitorimi, në shkurt 2024, shtator 2024 dhe mars 2025, dhe kreu një vizitë përfundimtare verifikimi në janar 2026. Monitorimi konfirmoi se aksesin e përkohshëm u garantua deri në funksionalizimin e zgjidhjes së përhershme, duke shmangur çdo pengesë për komunitetin gjatë periudhës së përfundimit të punimeve.

Në përfundim të procesit të monitorimit, nënkalimi pranë xhamisë ishte vënë në funksion për këmbësorët dhe automjetet e vogla, ndërsa rruga e shërbimit ishte ndërtuar dhe ishte vënë në funksion për automjetet e rënda. IPAM-i gjithashtu konfirmoi se hapat e nevojshme të shpronësimit për rrugën e shërbimit kishin avancuar në përputhje me procedurat kombëtare dhe kërkesat e BERZH-it, ndërkohë që vuri në dukje se vendimet dhe shumat e kompensimit mbeteshin jashtë tagrit të Marrëveshjes për Zgjidhjen e Problemit dhe mandatit të monitorimit të IPAM-it.

Çështja nxori mësim të vlefshme për ankesat e ardhshme infrastrukturore që lidhen me çështje akses:

- Së pari, përparimi i shpejtë është i mundur kur shqetësimi është i përcaktuar qartë, Palët janë të gatshme të angazhohen dhe zgjidhja e propozuar mund të përkthehet në angazhime teknike specifike.
- Së dyti, masat e përkohshme janë thelbësore kur punimet mund të shkaktojnë ndërprerje të menjëhershme të aksesit.
- Së treti, zgjidhjet teknike kanë më shumë gjasa të pranohen kur anëtarët e komunitetit të prekur përfshihen drejtpërdrejt në hartimin dhe verifikimin e tyre.
- Së katërti, nëse zbatimi varet nga miratimet e palëve të treta ose kërkon ndjekjen e procedurave vendore të pajisjes me leje, përditësimet periodike për komunitetin duhet të përfshihen në planin e monitorimit në mënyrë që të ruhet besimi te procesi.
- Së fundi, komunikimi i qartë mbi tagrin e Marrëveshjes është i rëndësishëm për menaxhimin e pritshmërive.

Pas një vizite përfundimtare verifikimi në janar 2026, IPAM-i përcaktoi se angazhimet sipas Marrëveshjes për Zgjidhjen e Problemit ishin përmbushur në mënyrë efektive dhe se nuk mbetej asnjë çështje e pazgjidhur brenda tagrit së dakordësuar. Megjithëse angazhimi teknik për instalimin e një tubacionin që do të mundësonte vendosjen e ndriçimit në të ardhme nuk mund të zbatohet për shkak të kufizimeve teknike, IPAM-i arriti në përfundimin se kjo nuk ndikonte në objektivin kryesor, atë të garantimit të aksesit të sigurt dhe funksional për këmbësorët, mjetet e vogla dhe mjetet e rënda.

Ky Raport do t'u shpërndalet Palëve dhe do të publikohet në dosjen virtuale të çështjes për [Çështjen 2023/02](#) në anglisht dhe në shqip, pas paraqitjes së tij për informacion para Bordit dhe Presidentit. Pas publikimit, IPAM-i do ta konsiderojë Çështjen të përfunduar me sukses dhe të mbyllur.

1. SFONDI

1.1. KËRKESA


Më 15 Dhjetor 2022 [Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit](#) (IPAM) mori një [Kërkesë](#) nga Zoti Ditmir Zeqa, i cili veproi si përfaqësues i 60 individëve (Kërkues) që banojnë në komunitetin e Bërxullës, në Bashkinë Vorë të Shqipërisë. Kërkesa lidhet me [Projektin e Hekurudhës Shqiptare](#) të financuar nga BERZH-I (OP ID 48466). Kërkuesit pretenduan se do të humbnin aksesin në bizneset e tyre, vendbanimet dhe në xhaminë lokale për shkak se kalimi hekurudhor në nivel që përdornin do të mbyllej pasi korridori hekurudhor të rrethohej me gardh. Megjithëse pranuan se Projekti parashikonte një kalim për automjete disa kilometra larg, ata e konsideruan atë shumë të largët për këmbësorët dhe vunë në dukje se rrugët lidhëse të aksesit nuk ishin të përshtatshme për mjete të rënda. Kërkuesit iu drejtuan procesit të Zgjidhjes së Problemit për trajtimin e shqetësimeve të tyre

1.2. PROJEKTI

[Projekti i Hekurudhës Shqiptare](#) (OP ID 48466) është një hua sovrane prej 36.87 milionë eurosh për Republikën e Shqipërisë dhe zbatohet nga Hekurudha Shqiptare. Projekti synon rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore me gjatësi 34.17 km ndërmjet Tiranës dhe Durrësit dhe ndërtimin e një lidhjeje të re hekurudhore prej afërsisht 5 km për të lidhur linjën ekzistuese Tiranë–Durrës me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe një lidhëse me linjën ekzistuese.

Projekti u miratua nga Bordi i BERZH-it më 30 nëntor 2016 dhe u klasifikua si kategori B sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale të Bankës të vitit 2014. Sipas [Dokumentit të Përmbledhjes së Projektit](#), Projekti do të përfshinte çështje specifike mjedisore dhe sociale, kryesisht për shkak të rrethimit të korridorit hekurudhor dhe mbylljes së një numri kalimesh që aktualisht përdoren nga komunitetet përgjatë hekurudhës.

Fotografia 1:



Linja Hekurudhore Tiranë - Durrës për tu rehabilituar (vija e kuqe), lidhje e re me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (vija blu)

Burimi: Kuadri për Përvetësimin e Tokës Për Projektin e Hekurudhës Shqiptare

1.3. TRAJTIMI DERI MË TANI

Kërkesa u regjistrua më 6 shkurt 2023 si [Çështja 2023/02](#) dhe IPAM-i filloi fazën e Vlerësimit, gjatë së cilës u angazhua me Kërkuesit, Hekurudhën Shqiptare, Bashkinë Vorë dhe ekipin e projektit të

BERZH-it për të kuptuar çështjet e ngritura dhe për të vlerësuar realizueshmërinë e një Iniciative për Zgjidhjen e Problemit.

Gjatë fazës së Vlerësimit, IPAM-i kreu një vizitë në terren dhe zhvilloi konsultime virtuale me të gjitha Palët. Këto angazhime konfirmuan se si Kërkuesit, ashtu edhe Klienti ishin të gatshëm të merrnin pjesë në një proces për Zgjidhjen e Problemit, i cili synonte identifikimin e një zgjidhjeje për çështjen aksesit që do të mbetej funksionale gjatë fazës së ndërtimit dhe do të siguronte lidhje të mjaftueshme për këmbësorët dhe automjetet pasi korridori hekurudhor të rrethohej me gardh. Bazuar në këto gjetje, IPAM-i përcaktoi se Iniciativa për Zgjidhjen e Problemit ishte e përshtatshme dhe mund të ndihmonte Palët të arrinin një zgjidhjeje të pranueshme në mënyrë reciproke.

[Iniciativa për Zgjidhjen e Problemit](#) u zhvillua gjatë korrikut 2023 dhe u përqendrua në sigurimin që zgjidhja teknike e propozuar nga Klienti të adresonte nevojat e Kërkuesve në lidhje me aksesin për këmbësorë dhe automjete, i cili do të zëvendësonte kalimin në nivel që komuniteti kishte përdorur për një kohë të gjatë. Për më tepër, Kërkuesit shprehën kërkesën për garanci që kalimi aktual në nivel të mbetej i hapur deri në momentin kur zgjidhja teknike të bëhej funksionale. Nga ana e tyre, Klienti kërkoi që komuniteti të lejonte vijimësinë e punimeve për ndërtimit hekurudhor.



Më 26 korrik 2023, IPAM-i lehtësoi zhvillimin e një takimi të përbashkët mes Palëve në Bërxull, ku Klienti i paraqiti zgjidhjen teknike Kërkuesve dhe e përshtati atë bazuar në komentet e tyre. Palët gjithashtu ranë dakord të vepronin me respekt të ndërsjellë gjatë periudhës së zbatimit. Në atë takim, Palët nënshkruan Marrëveshjen për Zgjidhjen e Problemit, e cila është konfidenciale sipas kërkesës së Palëve. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes, Çështja 2023/02 kaloi në fazën e Monitorimit të Zgjidhjes së Problemit, në mënyrë që IPAM-i të monitoronte zbatimin e saj.

2. VEPRIMTARITË E MONITORIMIT TË MARRËVESHJES

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Zgjidhjen e Problemit më 26 korrik 2023, IPAM filloi Monitorimin e Marrëveshjes për Zgjidhjen e Problemit për të mbikëqyrur zbatimin e zgjidhjes së dakordësuar të aksesit për komunitetin të Bërxullës. Monitorimi u krye përmes angazhimit të rregullt me Palët, shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave periodike në terren.

Tabela më poshtë ilustron afatin fillestar të përcaktuar për fazat e Zgjidhjes së Problemit dhe Monitorimit.


Tabela Çështjes 1. 2023/02 Kronologjia e Çështjes

Data	Veprimi
2022	
15 Dhjetor	Pranimi i Kërkesës
2023	
6 Shkurt	Njoftimi i regjistrimit
3 - 6 Prill	Misioni i vlerësimit në vendin e projektit
Qershor	Publikimi i Raportit të vlerësimit
Korrik	Misioni për Zgjidhjen e Problemit në vendin e projektit
26 Korrik	Nënshkrimi i Marrëveshjes për Zgjidhjen e Problemit
Tetor	Publikimi i Raportit Përmbledhës të Zgjidhjes së Problemit
2024	
Shkurt	Publikimi i Raportit të parë i monitorimit të Zgjidhjes së Problemit
Shtator	Publikimi i Raportit të dytë i monitorimit të Zgjidhjes së Problemit
2025	
Mars	Publikimi i Raportit të tretë të monitorimit të Zgjidhjes së Problemit
2026	
Janar	Vizitë monitorimi në vendin e projektit
Qershor	Publikimi i Raportit Përfundimtar

Raporti i parë i monitorimit, publikuar në shkurt 2024, konfirmoi se Palët kishin mbajtur komunikim konstruktiv dhe se dizajni i nënkalimit ishte dakordësuar bashkërisht me komunitetin. Gjatë kësaj periudhe, IPAM-i po ashtu u takua me Kërkuessit dhe Hekurudhën Shqiptare për të verifikuar se aksesu i përkohshëm do të mbetej i disponueshëm deri në momentin kur zgjidhja përfundimtare të bëhej funksionale.


Raporti i dytë i monitorimit, publikuar në shtator 2024, vuri në dukje se dizajni teknik për rrugën e shërbimit dhe nënkalimin ishte miratuar nga Mbikëqyrësi dhe se Kontraktori synonte të vijonte me punimet në pritje të miratimit financiar. Paralelisht, anëtarët e komunitetit kërkuan sqarime mbi afatet e zbatimit, përfshirë mundësinë e zgjatjes së shtrimit të asfaltit pranë xhamisë, diçka për të cilën IPAM-i i sqaroi se ishte jashtë tagrit së Marrëveshjes. Angazhimi gjatë kësaj periudhe konfirmoi se Kërkuessit vazhdonin të përdornin kalimin ekzistues në nivel dhe se Palët mbeteshin të përkushtuara ndaj zgjidhjes së dakordësuar.

Raporti i tretë i monitorimit, publikuar në mars 2025, konfirmoi progresin e vazhdueshëm mes Palëve që respektonin sjelljet e dakordësuara dhe mbanin komunikim të rregullt me IPAM-in. Hekurudha Shqiptare rikonfirmoi angazhimin e saj se kalimi ekzistues në nivel do të mbetej i hapur deri në momentin kur zgjidhja e re të bëhej plotësisht funksionale. Procesi i shpronësimit për tokën e nevojshme për rrugën e shërbimit avancoi në përputhje me kërkesat kombëtare dhe kërkesat e BERZH-it, ndërsa pritet një vendim i Këshillit të Ministrave përpara se pronarët e tokave të prekura të marrin pagesat e kompensimit.



Figurë 1: Foto e rrugës së shërbimit në ndërtim në Bërxull, dhjetor 2024

Në janar 2026, IPAM-i kreu një vizitë përfundimtare monitorimi për të verifikuar përfundimin e zgjidhjes së aksesit. Ndërtimi i rrugës së shërbimit kishte përfunduar dhe ajo ishte funksionale për qarkullimin e automjeteve. Për sa i përket nënkalimit pranë xhamisë si Klienti ashtu edhe Kërkesit konfirmuan se po i shërbente këmbësorëve dhe mjeteve të vogla, siç ishte parashikuar. IPAM-i verifikoi se marrëveshja e përkohshme, pra vazhdimi i përdorimit të kalimit në nivel, kishte mbetur në fuqi deri në momentin kur zgjidhja përfundimtare u vendos në funksion. Ekipi gjithashtu konfirmoi se pronarët e tokave që do të merrnin kompensim për shkak të shpronësimit të pjesshëm të tokës së tyre ishin informuar se dokumentet i ishin dorëzuar Këshillit të Ministrave. Megjithatë, theksuan se e kuptonin që procesi dhe shuma e kompensimit shkon përtej tagrit të IPAM-it. Vizita gjithashtu konfirmoi komunikimin e vazhdueshëm ndërmjet Palëve dhe se angazhimet sipas Marrëveshjes për Zgjidhjen e Problemit ishin përmbushur në mënyrë të qenësishme.



Figurë 2: Foto e përfunduar e rrugës së shërbimit në Bërxull, janar 2026



Figurë 3: Fotografi e nënkalimit në Bërxull, janar 2026

3. REZULTATET E ZGJIDHJES SË PROBLEMIT

Marrëveshja për Zgjidhjen e Problemit u përqendrua në ruajtjen dhe përmirësimin e aksesit për komunitetin e Bërxullës pas mbylljes së kalimit ekzistues në nivel, si pjesë e punimeve për rehabilitimin hekurudhor. Në përfundim të fazës së monitorimit, IPAM-i konfirmoi se angazhimet kryesore sipas Marrëveshjes ishin zbatuar dhe se zgjidhja e dakordësuar e aksesit ishte funksionale.

Rezultatet kryesore të procesit të Zgjidhjes së Problemit ishin: ndërtimi dhe funksionimi i një rruge shërbimi që mundësonte akses për mjete të rënda; ndërtimi i një nënkalimi pranë xhamisë për këmbësorët dhe mjeteve të vogla; sigurimi i vijimësisë së aksesit të përkohshëm përmes kalimit ekzistues në nivel deri në momentin kur zgjidhja përfundimtare të bëhej funksionale; dhe ruajtja e komunikimit ndërmjet Palëve gjatë zbatimit.

IPAM-i gjithashtu konfirmoi se procesi i shpronësimit i nevojshëm për rrugën e shërbimit kishte avancuar në përputhje me procedurat kombëtare dhe kërkesat e BERZH-it. Megjithatë vendimet dhe shumat e kompensimit mbetën jashtë tagrit të mandatit të Zgjidhjes së Problemit të IPAM-it, pronarët e tokave të prekur u informuan se dokumentacioni përkatës ishte dorëzuar në Këshillin e Ministrave.

Edhe pse angazhimi teknik lidhur me shtrirjen e një tubacioni që do të lejonte vendosjen e ndriçimit në të ardhshëm nuk mund të zbatohet për shkak të kufizimeve teknike, IPAM-i përcaktoi se kjo nuk ndikonte në objektivin kryesor të Marrëveshjes: sigurimin e aksesit të sigurt dhe funksional për këmbësorët, mjetet e vogla dhe mjetet e rënda. Në përmbyllje nuk mbeti asnjë çështje e pazgjidhur brenda tagrit të dakordësuar.

4. MËSIMET E NXJERRA

Procesi i monitorimit për Çështjen 2023/02 nxjerr në pah disa mësimet të rëndësishme për çështjet e ardhshme të Zgjidhjes së Problemit që lidhen me ndikimet në akses dhe punimet infrastrukturore.

1. Arritja e një marrëveshjeje të hershme për masa praktike të aksesit të përkohshëm është thelbësore. Mbajtja e kalimit ekzistues në nivel të hapur deri në momentin kur zgjidhja përfundimtare u bë funksionale ndihmoi në shmangien e ndërprerjeve dhe rriti besimin te procesi.

2. Përfshirja e drejtpërdrejtë e komunitetit i sjell përfitime zgjidhjeve teknike. Përshtatjet në dizajnin e rrugës së shërbimit dhe të nënkalimit, pas konsultimeve me Kërkuesit, ndihmuan në sigurimin që zgjidhja përfundimtare e aksesit t'u përgjigjej nevojave lokale.

3. Komunikimi i qartë mbi tagrin shmang keqkuptimet. Gjatë zbatimit, disa çështje të ngritura nga anëtarët e komunitetit binin jashtë tagrit të dakordësuar. Shpjegimi i vazhdueshëm i asaj që mbulonte Marrëveshja ndihmoi në menaxhimin e pritshmërive dhe ruajtën përqendrimin te zbatimi i zgjidhjes.

4. Planifikimi i fazës së zbatimit duhet të përfshijë bashkërendim mes autoriteteve publike. Zbatimi i zgjidhjes së aksesit varej nga bashkërendimi ndërmjet Hekurudhës Shqiptare, autoriteteve bashkiake, njësisë administrative dhe proceseve vendimmarrëse kombëtare, përfshirë procedurat e shpronësimit.

5. PËRFUNDIMI DHE HAPAT E ARDHSHËM

Duke u mbështetur të aktivitetet e monitorimit të ndërmarra që nga korriku 2023, IPAM-i ka përcaktuar se angazhimet e dakordësuar nga Palët gjatë Iniciativës për Zgjidhjen e Problemit për [Çështjen 2023/02](#) janë zbatuar në mënyrë efektive. Zgjidhja e aksesit, e përbërë nga rruga e shërbimit për mjete të rënda dhe nënkalimi për këmbësorët dhe mjetet e vogla, është funksionale, dhe Kërkuesit kanë konfirmuar se këto rregullime i japin përgjigje shqetësimeve të ngritura në Kërkesën e tyre.

Hekurudha Shqiptare ka përmbushur detyrimet e saj, përfshirë ruajtjen e aksesit të përkohshëm përmes kalimit ekzistues në nivel deri në përfundimin e infrastrukturës së re, avancimin e hapave të nevojshëm të shpronësimit dhe sigurimin e bashkërendimit me Bashkinë Vorë gjatë gjithë fazës së zbatimit. Kërkuesit kanë konfirmuar se angazhimet janë përmbushur dhe se nuk mbetet asnjë çështje e pazgjidhur brenda tagrit të Marrëveshjes.

Raporti do t'u shpërndahet Palëve dhe do të publikohet në Regjistrin e Çështjes në dosjen virtuale të [Çështja 2023/02](#) në anglisht dhe shqip, pas paraqitjes së tij për informacion pranë Bordit dhe Presidentit. Pas këtij publikimi, IPAM do ta konsiderojë çështjen të përfunduar me sukses dhe të mbyllur.